

MAK ALBANIA sh.p.k

Pasqyrat Financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2014  
Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

**PËRMBAJTJA:**

	<b>FAQE</b>
<b>RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR</b>	<b>2</b>
<b>PASQYRAT FINANCIARE:</b>	
<b>BILANCI KONTABËL</b>	<b>4</b>
<b>PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE</b>	<b>5</b>
<b>PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË</b>	<b>6</b>
<b>PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL</b>	<b>7</b>
<b>SHËNIME TË PASQYRAVE FINANCIARE</b>	<b>8-28</b>

## **RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR**

### **Për Drejtuesit dhe Aksionerët e**

Mak Albania shpk

### **Raport mbi pasqyrat financiare**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur këtij raporti të Mak Albania sh.p.k (ne vijim referuar si "Shoqëria") që përmbajnë bilancin kontabël më datë 31 dhjetor 2014 si dhe pasqyrën përkatëse të të ardhurave dhe shpenzimeve për këtë ushtrim, pasqyrën e fluksit të parasë dhe pasqyrën e ndryshimeve të kapitaleve të veta, dhe të tjera shënime sqaruese.

### **Përgjegjësitë e Drejtimit për Pasqyrat Financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Kjo përgjegjësi përfshin: përcaktimin, ushtrimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare të cilat nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve; zgjedhjen dhe zbatimin e parimeve të duhura kontabël; dhe kryerjen e çmuarjeve kontabël të arsyeshme për rrethanat financiare.

### **Përgjegjësitë e Audituesit të Pavarur**

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion për pasqyrat financiare duke u bazuar në auditimin e kryer. Ne kryem auditimin tonë në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin me qëllim që të përfitojmë një siguri të mjaftueshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për shumat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura janë në gjykimin e audituesit, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut të keq-deklarimeve materiale, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve. Gjatë vlerësimit të këtyre rreziqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare të shoqërisë në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat financiare, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë. Një auditim gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë të politikave kontabël të përdorura dhe përshtatshmërinë e çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e përgjithshëm të paraqitjes së pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që ne kemi siguruar janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë.

### Bazat për opinion me rezervë

1. Shoqëria është organizuar në pesë divizione të ndara sipas natyrës dhe pozicionit gjeografik të aktivitetit. Këto divizione janë: (i) Zyra Qendrore - Mak-Construction; (ii) Chateau Linza Motel & Restorant; (iii) Golem - Mali i Robit, Resort Motel & Restorant; (iv) Mak Travel dhe (v) Sheraton Tirana Hotel & Towers. Secili nga divizionet mban kontabilitet të veçantë dhe përgatit Pasqyrat e veta Financiare. Mak-Albania Shpk, përveç divizionit të Sheraton, i ka mbajtur llogaritë e divizioneve të tjera dhe i ka përgatitur Pasqyrat Financiare në USD. Shoqëria ka bërë përkthimin e Pasqyrave Financiare të secilit divizion nga USD në Lekë duke përdorur kurset e këmbimit siç shpjegohet në shënimin 3 të Pasqyrave Financiare dhe jo sipas kërkesave të SKK 12. Për shkak të natyrës së regjistrimeve të shoqërisë ne nuk jemi në gjendje të masim efektet potenciale në Pasqyrat Financiare që mund të rrjedhin si efekt i politikës kontabël të aplikuar nga shoqëria.
2. Shënimet e pasqyrave financiare nuk përfshijnë informacione në lidhje me palët e lidhura në përputhje me SKK 2.

### Opinion me rezervë

Sipas opinionit tone, me përjashtim te efekteve të çështjeve të përshkruara në bazat për opinion me rezervë, pasqyrat financiare të Shoqërisë Mak Albania Shpk japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të gjendjes financiare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2014 si dhe të rezultateve të aktivitetit të saj për ushtrimin e mbyllur më këtë datë në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

26 nëntor 2015



Zhuljeta Vehbiu  
Partner Angazhimi



Rr. Emin Duraku, Pall. "Binjaket",  
No.5, 1000, Tirana, Albania  
phone : +355 42 27 80 15  
[www.mazars.al](http://www.mazars.al) , [info@mazars.al](mailto:info@mazars.al)

MAK – ALBANIA sh.p.k  
Pasqyrat Financiare per vitin e mbyllur me 31.12.2014

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Bilancit Kontabël  
Më 31 Dhjetor 2014

	Shënime	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
<b>AKTIVE</b>			
<b>Aktive afatshkurtra</b>			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	4	260,773,765	322,593,781
Llogari të arkëtueshme	5	153,080,104	212,803,866
Aktive të tjera afatshkurtra	6	13,729,014	13,016,449
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	7	12,903,004	8,468,849
Inventari	8	61,179,800	57,010,405
<b>Total Aktiveve Afatshkurtra</b>		<b>501,665,687</b>	<b>613,893,350</b>
<b>Aktivët afatgjatë</b>			
Investime në pjesëmarrje	9	928,493,099	928,493,099
Aktive afatgjatë materiale	10	5,195,934,751	6,135,392,509
Aktive afatgjatë jomateriale	10	-	-
<b>Total aktive afatgjatë</b>		<b>6,124,427,850</b>	<b>7,063,885,608</b>
<b>Total Aktive</b>		<b>6,626,093,537</b>	<b>7,677,778,958</b>
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Hua afatshkurtra	11	282,313,500	249,556,950
Llogari të pagueshme tregëtare	12	138,305,322	215,657,670
Te pagueshme ndaj punonjësve	13	43,588,941	44,000,420
Detyrimet tatimore	14	11,840,724	10,518,522
Detyrime të tjera	15	97,237,355	104,551,108
Grantet dhe të ardhura të shtyra		1,105,806	605,806
Provizionet afatshkurtra	16	121,504,388	124,261,721
<b>Total Detyrime afatshkurtra</b>		<b>695,896,036</b>	<b>749,152,197</b>
<b>Detyrime afatgjatë</b>			
Hua afatgjatë	17	1,604,971,643	1,991,635,915
<b>Total Detyrime afatgjatë</b>		<b>1,604,971,643</b>	<b>1,991,635,915</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>2,300,867,679</b>	<b>2,740,788,112</b>
<b>Kapitali themeltar</b>			
Kapitali themeltar	18	11,907,024,000	11,907,024,000
Rezerva nga perkthimi në monedhe të huaj		1,808,440,665	1,865,889,977
Rezerva të tjera		335,252,274	306,595,489
Fitime të mbartura		(9,142,518,620)	(8,915,938,640)
Fitimi i ushtrimit		(582,972,461)	(226,579,980)
<b>Total kapitali themeltar</b>		<b>4,325,225,858</b>	<b>4,936,990,846</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>6,626,093,537</b>	<b>7,677,778,958</b>

Shënimet Shpjeguese janë pjesë integrale e pasqyrave financiare

MAK – ALBANIA sh.p.k  
 Pasqyrat Financiare per vitin e mbyllur me 31.12.2014  
 (Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve  
 Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

	Shënime	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Te ardhura	19	606,664,937	750,952,450
Te ardhura te tjera	20	395,264,902	160,132,127
Materiale te para dhe te konsumueshme	21	(295,382,482)	(433,024,377)
Shpenzime personeli	22	(166,596,515)	(173,662,074)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	10	(376,082,847)	(407,891,326)
Shpenzime te tjera	23	(697,195,353)	(84,452,014)
<b>Fitimi operativ</b>		<b>(533,327,358)</b>	<b>(187,945,214)</b>
Te ardhura dhe shpenzime financiare nga interesi		(20,559,057)	(16,115,377)
Fitimi dhe humbje nga kursi i kembimit		(429,261)	5,562,338
<b>Total shpenzime financiare</b>	24	<b>(20,988,318)</b>	<b>(10,553,039)</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>(554,315,676)</b>	<b>(198,498,253)</b>
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	25	-	-
<b>Fitimi i vitit</b>		<b>(554,315,676)</b>	<b>(198,498,253)</b>

*Shënimet Shpjeguese janë pjesë integrale e pasqyrave financiare*

MAK – ALBANIA sh.p.k  
Pasqyrat Financiare per vitin e mbyllur me 31.12.2014

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Fluksit të Parasë  
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

Shënime	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
<b>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</b>		
Fitimi para tatimit	(554,315,676)	(198,498,253)
Axhustime për zërat jo-monetare:		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	376,082,847	407,891,326
Te ardhura nga shitja e Aktiveve Afatgjata Materiale	341,603,396	2,293,950
Shpenzime për interesa	11,817,096	8,709,195
Fitimi operativ përpara ndryshimeve ne kapitalin qarkullues	<b>175,187,663</b>	<b>220,396,218</b>
<i>Ndryshimi ne kapitalin qarkullues</i>		
Ndryshimi ne inventar	(4,169,395)	48,977,728
Ndryshimi ne llogari te arketueshme dhe te tjera	54,577,042	281,480,556
Ndryshimi ne llogari te pagueshme dhe te tjera	(86,012,711)	(263,002,597)
<b>Mjetet monetare te gjeneruara nga aktivitetet operative</b>	<b>139,582,599</b>	<b>287,851,905</b>
Interesa te paguara	(11,817,096)	(8,709,195)
<b>Mjetet monetare neto nga aktivitetet operative</b>	<b>127,765,503</b>	<b>279,142,710</b>
<b>Aktivitetet investuese</b>		
Blerje te aktiveve afatgjata materiale	(24,729,800)	(13,323,959)
Shitje e aktiveve afatgjata materiale	246,501,315	
<b>Mjete monetare te gjeneruara nga aktiviteti investues</b>	<b>221,771,515</b>	<b>(13,323,959)</b>
<b>Aktivitetet financuese</b>		
(Ripagim)/ te hyra nga huate	(353,907,722)	(234,123,404)
Diferenca nga konvertimi i llogarive ne monedha te huaja	(57,449,312)	(24,539,597)
<b>Mjete monetare te gjeneruara nga aktiviteti financues</b>	<b>(411,357,034)</b>	<b>(258,663,001)</b>
<b>Ndryshimi neto i mjeteve monetare</b>	<b>(61,820,016)</b>	<b>7,155,750</b>
Mjetet monetare ne fillim te periudhës	322,593,781	315,438,031
<b>Mjetet monetare ne fund te periudhës</b>	<b>4 260,773,765</b>	<b>322,593,781</b>

Shënimet Shpjeguese janë pjesë integrale e pasqyrave financiare



**PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL**

	Kapitali themeltar	Rezerva		Fitim i pashperndare	Total
		R&R	konvertimi i monedhave te huaja		
<b>Pozicioni me 01.01.2013</b>	11,907,024,000	278,513,762	1,890,429,573	(8,915,938,640)	5,160,028,695
Efektet e ndryshimit te kurseve te kembimit gjate konsolidimit			(24,539,596)		(24,539,596)
Fitimi neto per periudhen kontabel				(198,498,253)	(198,498,253)
Rezervat		28,081,727		(28,081,727)	-
<b>Pozicioni me 31.12.2013</b>	11,907,024,000	306,595,489	1,865,889,977	(9,142,518,620)	4,936,990,846
Efektet e ndryshimit te kurseve te kembimit gjate konsolidimit			(57,449,312)		(57,449,312)
Fitimi neto per periudhen kontabel				(554,315,676)	(554,315,676)
Rezervat		28,656,785		(28,656,785)	-
<b>Pozicioni me 31.12.2014</b>	11,907,024,000	335,252,274	1,808,440,665	(9,725,491,081)	4,325,225,858

Administratoret i kane aprovuar pasqyrat financiare dhe shenimet e tjera shpjeguese ne vijim ne daten \_\_\_\_\_ 2015 dhe jane nenshkruar ne emer te tyre nga:

**Hisham Awad**

**Rimon Ziada**



Tel 23703 Fax 23768

**Aprovoi**

**Pergatiti**



## MAK ALBANIA sh.p.k

### Shenime mbi Pasqyrat Financiare te Shoqerise Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

#### SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE

##### 1. Te dhena te pergjithshme mbi Shoqerine

Mak Albania Shpk eshte krijuar ne vitin 1994, me vendim gjykate Nr. 4453, date 25 Maj 1994. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatese te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe nga statuti i saj.

Mak-Albania Sh.p.k eshte shoqeri shqiptare, me ortake:

- Heritage Glory Albania Ltd.
- Jassim Mohammed M.A. Al Kharafi, shtetas Kuvaitian
- Fawzi M.A. Al Kharafi, shtetas Kuvaitian

Administratoret e shoqerise jane:

- Z. Eyad J. MA Alkharafi
- Z. Jassim Mohammed M.A. Al Kharafi
- Z. Fawzi M.A. Al Kharafi

Aktiviteti i saj është kryer nëpërmjet pese divizioneve kryesore: atij të ndërtimit, në Tiranë, divizioni i Hotelit e kompleksit rezidencial në Linza, në Kavaje fshatin turistik në Malin e Robit në Golem), Sheraton Tirana Hotel, dhe Mak Travel. Nipti i shoqerise eshte J61821059A.

<u>Emertimi i Divizionit</u>	<u>Aktiviteti</u>	<u>Vendodhja</u>
Mak Albania Construction	Ndertim	Tirane
Chateau Linza Motel & Restaurant	Sherbim hotelerie	Tirane
Golem (Mali i Robit) Resort Motel & Restaurant	Sherbim hotelerie	Kavaje
Sheraton Tirana Hotel & Towers	Sherbim hotelerie	Tirane
Mak – Travel	Agjensi Udhetimi	Linza

Shoqëria për aktivitetin turistik të Malit të Robit, gëzon statusin e plotë të personit të stimuluar në turizëm; për Hotel Linzën gëzon statusin e personit të stimuluar në masën 50%; Po ashtu edhe për Hotel Sheraton Tirana, shoqëria gëzon statusin e Personit të Stimuluar në masën 100%.

## **MAK ALBANIA sh.p.k**

### **Shenime mbi Pasqyrat Financiare te Shoqerise**

**Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014(vazhdon)**

---

#### **2. Menyra e pergatitjes se Pasqyrave financiare**

##### **a. Menyra e Pergatitjes**

Pasqyrat Financiare te shoqerise jane pergatitur ne te gjitha aspektet e tyre materiale, ne perputhje me Ligjin Nr.9228 date 29.04.2004 dhe Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK) te shpallura ne date 15.06.2006.

Pasqyrat financiare te shoqerise jane pregatitur mbi bazen e kostos historike, me perjashtim te rasteve qe percaktohet ndryshe nese ka te tilla.

##### **b. Ndryshime ne metodat e vleresimit kontabel**

Rishikimi i vleresimit kontabel njihen ne periudhen ne te cilen vleresimi (cmuarja) eshte kryer dhe ne cdo periudhe qe preket ne te ardhmen.

##### **c. Monedha Funktionale dhe me te cilen paraqiten pasqyrat**

Pasqyrat Financiare paraqiten ne monedhen vendase Lek (ALL), e cila eshte monedha funksionale e shoqerise. Per qellime te mbajtjes se kontabiliteteit shoqeria ka perdorur 2 monedha raportuese, respektivisht ALL per divizionin e Sheraton Hotel dhe dollarin amerikan (USD) per te gjithë divizionet te tjera te shoqerise. Informacioni financiar eshte paraqitur ne Leke .

##### **d. Vlerësime dhe gjykime**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrorjës gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga keto vlerësime.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Efekte qe rrjedhin nga rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën keto vlerësime jane rishikuar si dhe në cdo periudhe te ardhshme.

Në vecanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare.

#### **3. Permbledhje e politikave te rendesishme kontabile**

Politikat kryesore kontabel te zbatuara nga shoqeria jane te pershkruara ne vijim:

##### **a. Instrumentat Financiare**

Instrumentat financiarë jo-derivativë te shoqerise përbëhen nga llogari të arkëtueshme, likuiditete dhe vlera arke te tjera, hua të marra dhe të dhena, dhe llogari të pagueshme.

##### **i. Njohja fillestare dhe c'registrimi**

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë e kushteve kontraktuale të instrumentit ne fjale. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç rasteve siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në shpenzime dhe të ardhura.

---

*Shënimet Shpjeguese janë pjesë integrale e pasqyrave financiare*

**MAK ALBANIA sh.p.k**  
**Shenime mbi Pasqyrat Financiare te Shoqerise**  
**Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014(vazhdon)**

---

Aktivitetet financiare ç'regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivitetin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Detyrimet financiare ç'regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë perfundojnë, skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

**ii. Njohja e metejshme**

**Paraja dhe ekuivalentët e parasë**

Paraja dhe ekuivalentët e parasë (mjetet monetare) përfshijnë tepricat e arkës, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllime të pasqyrës së fluksit të parasë, paraja dhe ekuivalentët të saj përfshijnë depozita pa afat dhe ato me një maturimi prej tre muajsh ose më pak që nga data fillestare. Likuiditetet dhe vlera arke të tjera maten me tej me koston e amortizuar pakesuar me humbjet nga zhvleresimet.

**Huate dhe Llogari të arkëtueshme**

Huate e dhena dhe Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Llogaritë e arkëtueshme afatshkurtra nuk skontojnë.

**Llogari të pagueshme**

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv nëse është materiale.

**Hua të marra dhe të dhëna**

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht me vlerën e drejtë, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar në interesin efektiv. Kostot e huadhenies kapitalizohen si pjesë e koston të një aktiviteti që kërkon domosdoshmerisht një periudhë të rendesishme për t'u paguar për përdorimin e destinuar apo shitjen e tij. Fitimet dhe humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur aktivitetet dhe detyrimet financiare të mesiperme zhvlerësohen sikurse dhe nepermjet procesit të amortizimit.

**iii. Zhvleresime të aktiveve financiare**

Një aktiv financiar konsiderohet si i zhvlerësuar në ato raste kur ekzistojnë kushte objektive që tregojnë se një apo më shumë ngjarje (pas njohjes së tij fillestare) kanë efekte negative në flukset e ardhshme të parasë që parashikohet të burojnë prej atij aktiviteti. Vështiresitë e konsiderueshme financiare të debitorit, probabiliteti që debitori do të falimentojë apo një riorganizim financiar, dhe pamundësia apo shkeljet në pagesa konsiderohen si tregues që një llogari e arkëtueshme është e zhvlerësuar.

---

*Shënimet Shpjeguese janë pjesë integrale e pasqyrave financiare*

**MAK ALBANIA sh.p.k**  
**Shenime mbi Pasqyrat Financiare te Shoqerise**  
**Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014(vazhdon)**

---

Aktivitet e rendesishme financiare testohen ne menyre individuale per zhvleresim. Aktivitet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, mbi baze grupesh që kanë karakteristika të ngjashme të riskut financiar.

Humbja nga zhvleresimi lidhur me nje aktiv financiar te matur me kosto te amortizuar, llogaritet si diferenca midis vleres kontabel te aktivitet dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parase, te skontuara me normen efektive te interesit te aktivitet. Vlera e nje aktivitet zvogelohet nepermjet llogarise per zhvleresime dhe vlera e humbjes nga zhvleresimi njihet ne pasqyren e e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Te ardhurat nga interesi vazhdojne te rriten mbi vleren kontabel te aktualizuar, bazuar ne normen origjinale efektive te aktivitet. Llogarite e arketueshme se bashku me fondin rezerve te zhvleresimit qe i shoqeron c'regjistrohen ateherë kur nuk ka shpresa per rikuperim real ne te ardhmen.

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitet. Nëse ne nje vit pasues, shuma e humbjeve te vleresuara nga zhvleresimi rritet apo ulet per shkak te nje ngjarje pas njohjes fillestare te aktivitet, humbja nga zhvleresimi i njohur me pare rritet apo reduktohet duke rregulluar llogarine e fondit rezerve te zhvleresimeve. Nëse nje aktiv i cregjistruar me pare, rikuperohet, ky rikuperim njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

**iv. Zhvleresimi i Aktiveve jo-financiare**

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivitet tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

**v. Kompensimi i Intrumentave financiare**

Aktivitet dhe pasivet financiare netohen dhe shuma e tyre raportohet neto ne bilanc nese, dhe vetem nese ka nje te drejte te detyrueshme ligjore per te netuar shumen e njohur dhe ekziston mundesia per te shlyer ne shumen neto, apo per te realizuar aktivitet dhe shlyer pasivet njekohesisht.

**vi. Percaktimi i Vleres se Drejte**

Vlera e drejte e parase dhe e likuiditeteve, llogarive te arketueshme dhe llogarive te pagueshme jane afersisht te barabarta me vleren kontabel te dhene, per shkak te maturimit te tyre afatshkurter.

**vii. Të tjera**

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

**viii. Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

**b. Inventari**

Inventari i imet është përfshirë në këtë grup sipas rregullave kontabile në Shqipëri. Inventari paraqitet me vlerën me të ulët mes koston dhe vlerës neto realizueshme. Vlera e realizueshme neto është çmimi i shitjes i përlogaritur gjatë rrjedhës normale të biznesit, pa koston e përlogaritur të perfundimit dhe shpenzimet e shitjes. Kostot e inventarit janë përlogaritur duke u bazuar në metodën e mesatares së ponderuar dhe përfshin shpenzimet e kryera gjatë blerjes së inventarit dhe e dergimit të tyre në kushtet dhe vendodhjen ekzistuese. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuar në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

**c. Investime në pjesëmarrje**

Investimet në pjesëmarrje fillimisht njihen me kosto. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e pjesëmarrjes në fjale.

**d. Aktivet Afatgjata Materiale (AAM)**

**i. Njohja dhe matja**

Zerat e llogarise toka, ndertesa, makineri dhe pajisje janë të paraqitura me vlerën e drejte duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Te gjitha aktivet e tjera afat-gjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjëndje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjëndjen e mëparshme të vendodhjes së aktivit.

Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afat-gjate materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentet më të mëdhenj) të aktiveve afat-gjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

**ii. Kostot e mëpasshme**

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afat-gjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të

**MAK ALBANIA sh.p.k**  
**Shenime mbi Pasqyrat Financiare te Shoqerise**  
**Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014(vazhdon)**

---

besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

**iii. Amortizimi**

Amortizimi i aktiveve llogaritet mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afat-gjate material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes.

Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Amortizimi kalohet në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve.

Normat e amortizimit të aplikuara janë referuar kërkesave fiskale në Ligjin 8438 date 28.12.1998 "Per tatimin mbi të ardhurat" dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave No.5 date 30.01.2006 dhe nuk marrin në konsideratë vlerësimin e amortizimit sipas jetës së dobishme të aktivitetit.

Normat vjetore të amortizimit të përdorura, bazuar janë si më poshtë:

Aktive Afatgjata Materiale	Norma e amortizimit %		Metoda e llogaritjes
	2014	2013	
Ndertesa dhe instalime	5	5	
Makineri e pajisje	20	20	
Mjete transporti	20	20	
Mobilje orendi	20	20	Mbi Vlerën e mbetur
Pajisje elektronike	25	25	

Amortizimi nuk aplikohet për tokën dhe punimet në proces që nuk janë në funksionim.

**iv. C'regjistrimi**

Nje ze i aktiveve afatgjata materiale c'regjistrohet kur ai nxirret jashte perdorimit apo atehere kur nuk priten me perfitime ekonomike te ardhshme nga perdorimi apo nxjerrja e tij jashte perdorimit.

Fitimet dhe humbjet ne rastin e nxjerrjes jashte perdorimit te aktiveve afatgjata materiale percaktohen sipas shumes se tyre te mbetur dhe merren parasysh ne nxjerrjen e rezultatit operativ te ushtrimit.

**e. Aktivet afatgjata Jomateriale**

Aktivitetet afatgjata jomateriale perfshijne shpenzimet e nisjes se aktivitetit te hotelit te sheraton, dhe koston e softwere ne perdorim te shoqerise.

**i. Njohja dhe Matja**

AAJM paraqiten me kosto minus amotizimin e akumuluar (shihni me poshte) dhe humbjet e akumuluar nga zhvleresimi, nese ka.

**ii. Shpenzimet pasuese**

Shpenzimet pasuese kapitalizohen vetem ne rastin kur shtojne perfitimet e ardhshme ekonomike te trupezuara ne aktivin specifik me te cilat ato lidhen. Te gjitha shpenzimet njihen si fitim apo humbje ne momentin kur kryhen.



**MAK ALBANIA sh.p.k**  
**Shenime mbi Pasqyrat Financiare te Shoqerise**  
**Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014(vazhdon)**

---

**iii. Amortizimi**

Amortizimi njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve duke perdorur metoden lineare mbi jetegjatesine e parashikuar te aktiveve te patrupezuara qe nga data qe jane te disponueshme per perdorim. Jetegjatesia e parashikuar e aktiveve per periudhat aktuale dhe krahasuese eshte si me poshte:

Shpenzimet e nisjes te aktivitetit	7 vjet
Programe kompjuterike	5 vjet

**f. Zhvleresimi (Renia ne vlere)**

Shoqeria vlereson ne çdo date raportimi nese ka premisa qe nje aktiv te zhvleresohet. Ne rast se evidentohet mundesia per zhvleresim, atehere vleresohet vlere e rikuperueshme e aktivitetit. Per aktivet e patrupezuara qe nuk jane te gatshme per perdorim, vlere e rikuperueshme perlogaritjet ne çdo date te bilancit.

Nje zhvleresim njihet atehere kur vlere kontabel e nje aktiv apo vlere e flukseve qe do te gjeneroje, eshte me e madhe se vlere e rikuperueshme e aktivitetit. Vlere e flukseve qe gjenerohen eshte grupi me i vogel i identifikueshem i aktiveve qe gjeneron flukse te parase qe jane kryesisht te pavarur nga aktivet dhe grupet e tjera. Humbjet nga zhvleresimet njihen ne pasqyren e fitimeve dhe humbjeve. Vlere e rikuperueshme e nje aktiv apo nje njesie qe gjeneron flukse paraje eshte me e madhe midis vleres se tij ne perdorim dhe vleres se drejte e tij, minus kostot e shitjes. Per te vleresuar vleren ne perdorim, flukset e ardhshme te parashikuara te parase aktualizohen nga vlere e tyre ekzistuese duke perdorur nje norme aktualizimi pa llogaritje tatimit, e cila reflekton vleresimet aktuale te tregut te vleres monetare ne kohe dhe rreziqet specifike qe kane lidhje me ate aktiv.

Humbja nga zhvleresimi kthehet nese ka indikator qe kjo humbje nuk ekziston me dhe ka pasur nje ndryshim ne perlogaritjet e perdorura per te percaktuar shumen e rikuperueshme. Nje humbje nga zhvleresimi kthehet vetem deri ne shkallen qe gjendja e mbartur e aktivitetit nuk eshte me madhe se gjendja e mbartur qe do te ishte percaktuar, neto e zhvleresimit dhe amortizimit, ne rast se nuk ka qene njohur asnje humbje nga zhvleresimi.

**g. Provizionet**

Nje provizion njihet nese, si rezultat i nje ngjarjeje te shkuar, shoqeria ka nje detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund te vleresohet ne menyre te besueshme dhe do te kerkoje flukse dalje parash per shlyerjen e tij. Provizionet percaktohen duke skontuar (nese eshte materiale) flukset e pritshme te ardhshme te parasë me nje norme skontimi para tatimit qe pasqyron vleresimet aktuale te tregut per vleren ne kohe te parasë dhe per risqet qe lidhen me detyrimin ne fjale.

**h. Konvertimi i monedhave te huaja**

Transaksionet ne monedhe te huaj jane konvertuar ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates ne te cilin eshte kryer transaksioni, dhe me pas jane konvertuar ne monedhen raportuese me nje kurs fiks vjetor te perdorur nga shoqeria.

Aktivitetet dhe pasivet monetare ne monedhe te huaj ne daten e mbylljes se bilancit jane rivleresuar ne monedhen funksionale sipas kursit te shpallur nga Banka e Shqiperise ne daten e mbylljes se periudhes ushtrimore. Diferencat qe rrjedhin si rezultat i rikonvertimit njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

*Shënimet Shpjeguese janë pjesë integrale e pasqyrave financiare*

**MAK ALBANIA sh.p.k**  
**Shenime mbi Pasqyrat Financiare te Shoqerise**  
**Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014(vazhdon)**

Regjistrimet kontabel mbahen me vete per cdo division. Pervec divisionit te Sheratonit te gjitha divizionet e tjera i mbajne regjistrimet ne USD. Transaksionet jane kryer kryesisht ne Lek (ALL), ne EUR, dhe USD.

Transaksionet ne monedhe tjeter nga Dollari Amerikan jane rregjistruar me kurs fiks si vijon:

Per perkthimin e Pasqyrave financiare nga Dollari Amerikan ne Leke jane perdorur keto rregulla per kurset e kembimit si vijon: Llogarite e Bilancit		Kurset e kembimit te perdorura per perkthimin e PF ne ALL	Kursi ne Leke
AAM	Hyrjet	Kursi i kembimit qe mbizoteron ne ditën e transaksionit.	
	Daljet	Kursi mesatar i cdo kategorie te AAM ne fillim te periudhes.	
	Amortizimi	Me kursin fiks te perdorur nga shoqeria	100
Llogarite aktive dhe Detyrimet		Kursi i kembimit i Bankes se Shqiperise ne datën e pasqyrave financiare.	115.23
Inventari dhe detyrimet ndaj shetit		Kursi i kembimit real i perdorur ne hedhje	100
Kapitali	Kapitali i nenshkruar	Kursin historik.	
	Fitime te mbartura	Kursi mesatar i kembimit perdorur ne fillim te periudhes.	
	Humbje fitime te vitit	Mesatare ndermjet kursit te te Ardhurave dhe Shpenzimeve te vitit ushtrimor.	
Te Ardhurat dhe Shpenzimet	Te Ardhurat	Kursi mesatar te hedhur	100.79
	Shpenzimet	Me kursin fiks te perdorur nga shoqeria	100

Perjashtim nga ky rregull bejne zera per te cilat eshte perdorur kursi historik sic jane parapagimet. Rezultati nga diferenca e kurseve te kembimit nga perkthimi i Pasqyrave Financiare nga Dollari Amerikan ne Leke mbarthen ne Pasqyren e Bilancit. Keto diferenca jane paraqitur ne grupin e Kapitaleve, si rezerve nga perkthimi i pasqyrave ne monedhe te huaj.

Asetet dhe detyrimet jo monetare qe maten me kosto historike ne monedhe te huaj perkthehen duke perdorur kursine kembimit ne datën e transaksionit.

Asetet dhe detyrimet jo monetare ne monedhe te huaj qe paraqiten me vleren e drejte perkthehen me kursin e kembimit ne datën kur vlere e drejte eshte percaktuar.

Kursi i kembimit per dy monedhat e huaja kryesore me monedhen vendase sipas te Bankes se Shqiperise me 31.12.2014, ka qene respektivisht si me poshte:

	<u>2014</u>	<u>2013</u>
1 Euro	140.14	140.20
1 USD	115.23	101.86

*Shënimet Shpjeguese janë pjesë integrale e pasqyrave financiare*

**MAK ALBANIA sh.p.k**  
**Shenime mbi Pasqyrat Financiare te Shoqerise**  
**Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014(vazhdon)**

---

**i. Te Ardhurat**

Të ardhurat janë përfitimet ekonomike bruto (pa TVSH dhe zbritjet tregtare), të marra gjatë periudhës kontabël, si rezultat i rrjedhës normale të veprimtarisë së njësisë ekonomike raportuese, atëherë kur këto përfitime ekonomike çojnë në rritjen e kapitaleve të veta. Te Ardhurat njihen me vlerën e drejte të shumës së arketuar ose të arketueshme.

**i. Sherbimet**

Te ardhurat nga sherbimet regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në proporcion me përfundimin e sherbimit në datën e raportimit. Te ardhurat nga sherbimet konsistojnë në (a) sherbimet e hotelerisë dhe ato të lidhura me to (b) sherbimet e bar restorant, (d) sherbimet e dhenies së ambjenteve me qira.

**ii. Mallrat**

Te ardhurat nga shitja e mallrave njihen në momentin e dorëzimit të mallrave kur e drejta e pronësive dhe rreziku i humbjes i kalojnë klientit duke i zbritur apo neto nga uljet e lejuara.

**iii. Qirate Operative**

Te ardhurat nga qirate operative njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në bazë të metodës lineare sipas kohezgjatjes mbi kushtet kontraktuale të qerases.

**j. Te Ardhurat dhe shpenzimet Financiare**

Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur akumulohen, duke marrë parasysh metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet për interesa përfshijnë interesin e pagueshem mbi borxhet e marra për qëllime të kapitalit të punës, të përlogaritur me metodën e normës efektive të interesit.

**k. Shpenzimet**

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe Shpenzimeve në momentin e kryerjes së tyre.

**l. Tatimi mbi fitimin**

Tatim fitimi apo humbjet e vitit përbehet nga tatimi aktual. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zera që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi i prituri për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si edhe çfaredolloj rregullimi kontabel të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2014 dhe 2013 paraqiten me poshte:

	Viti 2014	Viti 2013
Perqindja e Tatimit mbi Fitimin	15%	10%

**MAK ALBANIA sh.p.k**  
**Shenime mbi Pasqyrat Financiare te Shoqerise**  
**Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014(vazhdon)**

**m. Fondet per pensione**

**i. Kontributet per Sigurimet Shoqerore te detyruara**

Shoqeria paguan kontributet per pensione si edhe kontribute per sigurime shendetesore per punonjesit e saj sic eshte parashikuar ne legjislacionin social ne Shqiperi. Kontributet, bazuar ne pagat, jane paguar ne llogari te organizmave kombetare pergjegjes per pagesen e pensioneve dhe shpenzimeve shendetesore. Kontributet e llogaritura ne emer te Shoqerise ngarkohen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve ne momentin qe ato ndodhin. Nuk ka asnje detyrim tjetër ne lidhje me fondin per pensione dhe shpenzime shendetesore.

**ii. Lejet Vjetore te Pagueshme**

Shoqeria njihet ne shpenzimet per paga dhe koston e lejeve vjetore te pakonsumuara. Ky parashikim i shpenzimeve mbyllet ne momentin e konsumimit te lejeve.

**n. Zerat jashte bilancit**

Marreveshjet e regjistruara jashte bilancit pasqyrojne kontratat (pa transferim parash) midis Shoqerise dhe Institucioneve Financiare. Keto kontrata, ne pergjithesi, jane per detyrime financiare ose garanci. Ato paraqesin detyrimin e Shoqerise ndaj Bankes per te kryer dicka gjate ose deri ne nje periudhe te caktuar kohore. Keto marreveshje regjistrohen kur detyrimi ka lindur. Vlera qe regjistrohet ne zerat jashte bilancit korespondon me shumen e garantuar ose me vleren e kontraktuar sipas marreveshjes. Ne daten e maturimit behet anulimi i veprimit.

**4. Paraja dhe ekuivalentët e saj**

	<u>2014</u>	<u>2013</u>
Arka	219,351	207,645
Banka	260,554,414	322,386,136
	<u>260,773,765</u>	<u>322,593,781</u>

**5. Llogari të arkëtueshme**

Kerkesat per arketim ndaj klienteve sipas secilit divizion te Shoqerise jane si me poshte sipas divizioneve:

	<u>2014</u>	<u>2013</u>
Sheraton Tirana Hotel & Towers	39,146,516	25,776,488
Mak Albania Construction	110,412,497	183,361,518
Chateau Linza	3,521,091	2,865,831
Golem Resort	-	800,029
Mak- Travel	-	-
	<u>153,080,104</u>	<u>212,803,866</u>

**MAK ALBANIA sh.p.k**  
**Shenime mbi Pasqyrat Financiare te Shoqerise**  
**Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014(vazhdon)**

**5.1 Kliente per shitje e sherbime sipas natyres**

	<u>2014</u>	<u>2013</u>
Llogari te arketueshme tregtare	159,087,710	218,369,062
Zhvleresimi i llogarive te arketueshme	(6,264,650)	(5,822,240)
Llogari te a arketueshme tregtare neto	<u>152,823,060</u>	<u>212,546,822</u>
Depozita garancie	257,044	257,044
	<u><u>153,080,104</u></u>	<u><u>212,803,866</u></u>

**5.2 Humbjet nga zhvleresimi i Kerkesave per Arketim te Sheraton Hotel**

	<u>2014</u>		<u>2013</u>	
	<u>Llogari te arketueshme</u>	<u>Zhvleresimi</u>	<u>Llogari te arketueshme</u>	<u>Zhvleresimi</u>
Pa kaluar afati	37,316,605		24,328,376	
61-90 dite	2,198,938	(626,071)	1,054,867	(451,500)
91-120 dite	93,690	(93,690)	908,951	(321,250)
121 - vazhdim	5,544,889	(5,544,889)	5,049,490	(5,049,490)
	<u>45,154,122</u>	<u>(6,264,650)</u>	<u>31,341,684</u>	<u>(5,822,240)</u>

**6. Aktive të tjera afatshkurtra**

	<u>2014</u>	<u>2013</u>
Sheraton Tirana Hotel & Towers	3,657,364	1,016,970
Mak Albania Construction	9,651,964	11,505,963
Chateau Linza	419,686	413,803
Golem Resort	-	79,713
Mak- Travel	-	-
	<u>13,729,014</u>	<u>13,016,449</u>

Ne zerin e aktiveve te tjera afatshkurtra perfshihet edhe vlera prej 1,995,531Lek qe perfaqeson parapagimin e tatimit ndaj fitimit te mbetur gjendje sipas sistemit te tatimeve me 31 dhjetor 2014.

**MAK ALBANIA sh.p.k**  
**Shenime mbi Pasqyrat Financiare te Shoqerise**  
**Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014(vazhdon)**

**7. Parapagime dhe shpenzime të shtyra**

	<u>2014</u>	<u>2013</u>
Sheraton Tirana Hotel & Towers	7,067,819	2,245,299
Mak Albania Construction	5,633,101	6,032,550
Chateau Linza	202,084	191,000
Golem Resort	-	-
Mak- Travel	-	-
	<u><b>12,903,004</b></u>	<u><b>8,468,849</b></u>

**8. Inventari**

	<u>2014</u>	<u>2013</u>
Lendet e Para	34,070,550	39,228,616
Mallra	28,822,556	23,189,123
Provizione	(1,713,306)	(5,407,334)
	<u><b>61,179,800</b></u>	<u><b>57,010,405</b></u>

**9. Investime Financiare ne Pjesemarrje**

Aktivt financiare perfaqesojne pjesemarrjen e plote ne masen 100% te shoqerise ne kapitalin e shoqerise Alfa Butrinti Sh.p.k.

	<u>2014</u>	<u>2013</u>
Pjesemarrje ne shoqeri te kontrolluara	928,493,099	928,493,099
	<u><b>928,493,099</b></u>	<u><b>928,493,099</b></u>



Shenime mbi Pasqyrat Financiare te Shoqerise  
Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014(vazhdon)

10. Aktivet Afat Gjata Materiale dhe Jo Materiale

	Toke	Ndërtesa	Makineri dhe pajsje	Mjete transporti	Te tjera AMM	Ne proces	Totali AAM	Totali AAJM
<i>Kosfo</i>								
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	153,383,380	9,107,562,753	1,763,158,543	38,030,488	1,465,318,484	113,514,292	12,640,967,940	75,269,128
Shtesa	-	2,730,340	10,593,619	-	-	-	13,323,959	
Riklasifikimi i inventareve ne AMM	-	-	18,247,616	-	-	-	18,247,616	
Te shitura	-	-	(18,247,616)	-	-	-	(18,247,616)	
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	(83,326,993)	(77,714,193)	(7,808,972)	(2,010,724)	(1,045,628)	(171,906,510)	
<b>Gjëndja më 31 Dhjetor 2013</b>	<b>153,383,380</b>	<b>9,026,966,100</b>	<b>1,696,037,969</b>	<b>30,221,516</b>	<b>1,463,307,760</b>	<b>112,468,664</b>	<b>12,482,385,389</b>	<b>75,269,128</b>
Shtesa	-	114,794,576	-	-	22,403,888	(112,468,664)	24,729,800	
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	(1,023,633,359)	(116,009,644)	-	(204,393,543)	-	(1,344,036,546)	(13,093,374)
<b>Gjëndja më 31 Dhjetor 2014</b>	<b>153,383,380</b>	<b>8,118,127,317</b>	<b>1,580,028,325</b>	<b>30,221,516</b>	<b>1,281,318,105</b>	<b>-</b>	<b>11,163,078,643</b>	<b>62,175,754</b>
<i>Amortizimi i akumuluar</i>								
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	-	3,596,654,899	1,275,791,293	37,289,547	1,199,001,377	-	6,108,737,116	75,246,128
Amortizimi i vitit	-	256,194,981	98,340,552	157,450	53,175,343	-	407,868,326	23,000
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	(82,078,673)	(77,714,193)	(7,808,972)	(2,010,724)	-	(169,612,562)	
<b>Gjëndja më 31 Dhjetor 2013</b>	<b>-</b>	<b>3,770,771,207</b>	<b>1,296,417,652</b>	<b>29,638,025</b>	<b>1,250,165,996</b>	<b>-</b>	<b>6,346,992,880</b>	<b>75,269,128</b>
Amortizimi i vitit	-	255,670,203	79,558,423	116,698	40,737,523	-	376,082,847	
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	(473,888,648)	(109,793,756)	-	(172,249,431)	-	(755,931,835)	(13,093,374)
<b>Gjëndja më 31 Dhjetor 2014</b>	<b>-</b>	<b>3,552,552,762</b>	<b>1,266,182,319</b>	<b>29,754,723</b>	<b>1,118,654,088</b>	<b>-</b>	<b>5,967,143,892</b>	<b>62,175,754</b>
<i>Vlera neto kontabël</i>								
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	153,383,380	5,510,907,854	487,367,250	740,941	266,317,107	113,514,292	6,532,230,824	23,000
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	153,383,380	5,256,194,893	399,620,317	583,491	213,141,764	112,468,664	6,135,392,509	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	153,383,380	4,565,574,555	313,846,006	466,793	162,664,017	-	5,195,934,751	-

Shënimet Shtepjeguese janë pjesë integrale e pasqyrave financiare

**MAK ALBANIA sh.p.k**  
**Shenime mbi Pasqyrat Financiare te Shoqerise**  
**Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014 (vazhdon)**

**11. Hua afatshkurtra**

Detyrime ndaj bankave ne formen e overdraftit sipas secilit divizion te Shoqerise eshte si vijon:

	<u>2014</u>	<u>2013</u>
Hua Afatshkurtra (Overdraft)	282,313,500	249,556,950
	<u>282,313,500</u>	<u>249,556,950</u>

**12. Llogari të pagueshme tregtare**

Detyrimet ndaj furnitoreve sipas secilit divizion te Shoqerise jane si me poshte:

	<u>2014</u>	<u>2013</u>
Sheraton Tirana Hotel & Towers	17,887,417	18,464,630
Mak Albania Construction	110,412,496	179,721,566
Chateau Linza	10,005,409	12,967,119
Golem Resort	-	4,504,355
Mak- Travel	-	-
	<u>138,305,322</u>	<u>215,657,670</u>

**13. Te pagueshme ndaj punonjesve**

Marredheniet kontraktuale te shoqerise me punonjesit e tyre bazohen ne kodin e punes te Republikes se Shqiperise. Kontrata kolektive e punes dhe kontratat individuale jane lidhur ndermjet shoqerise dhe punonjesve te saj per percaktimin e detyrimeve reciproke qe lindin nga maredhenia e punes.

Detyrimet ndaj punonjesve sipas secilit divizion te Shoqerise jane 43,588,941 LEK per 31 dhjetor 2014 (2013: 44,000,420 LEK)

**14. Detyrimet Tatimore**

Detyrime ndaj shtetit sipas secilit divizion te Shoqerise eshte si vijon:

	<u>2014</u>	<u>2013</u>
Sigurime shoqerore dhe shendetsore, TAP	3,818,033	3,704,951
Tatimi mbi vleren e shtuar	6,892,007	5,822,446
Detyrime te tjera	1,130,684	991,125
	<u>11,840,724</u>	<u>10,518,522</u>

*Shënimet Shpjeguese janë pjesë integrale e pasqyrave financiare*

**MAK ALBANIA sh.p.k**  
**Shenime mbi Pasqyrat Financiare te Shoqerise**  
**Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014 (vazhdon)**

**15. Detyrime te tjera**

	<u>2014</u>	<u>2013</u>
Parapagime	50,238,232	37,940,056
Detyrime te tjera	46,999,123	66,611,052
	<u><b>97,237,355</b></u>	<u><b>104,551,108</b></u>

**16. Provizione Afatshkurtra**

	<u>2014</u>	<u>2013</u>
Gjendja ne fillim	124,261,721	124,261,721
Krijimi i provizioneve	-	-
Rimarrja e provizioneve	(2,757,333)	-
Gjendja ne fund	<u><b>121,504,388</b></u>	<u><b>124,261,721</b></u>

**17. Hua Afatgjata**

Shoqeria ka marre hua ndaj ortakeve me qellim te financimit te investimeve si edhe per mbulimin e nevojave per kapital punues. Per keto hua nuk jane llogaritur apo paguar interesa. Gjendja e huase me 31 dhjetor 2014 eshte 1,604,971,643 LEK (2013: 1,991,635,915 LEK).

**18. Kapitali themeltar**

	<u>2014</u>		<u>2013</u>	
	%	Kapitali i nenshkruar	%	Kapitali i nenshkruar
Heritage Glory Albania Ltd	97.98	11,666,478,060	97.98	11,666,478,060
Jassim M.A Al Kharafi	1.01	120,272,970	1.01	120,272,970
Fawzi M.A Al Kharafi	1.01	120,272,970	1.01	120,272,970
<b>TOTAL</b>	<u><b>100.00</b></u>	<u><b>11,907,024,000</b></u>	<u><b>100.00</b></u>	<u><b>11,907,024,000</b></u>

**MAK ALBANIA sh.p.k**  
**Shenime mbi Pasqyrat Financiare te Shoqerise**  
**Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014 (vazhdon)**

**19. Te ardhura**

Struktura e te ardhurave operacionale te kryera deri me 31 Dhjetor 2014 paraqitet si me poshte:

	<u>2014</u>	<u>2013</u>
Te ardhura nga dhomat- te huajt	310,733,827	271,866,096
Te ardhura nga dhomat- grupet	94,365,329	119,624,945
Te ardhura nga ap. Te hotelit - te huajt	6,042,891	6,932,609
Te ardhura nga dhoma te tjera	686,586	924,514
Te ardhura nga qera LRC - i mobiluar	2,141,661	2,251,285
Te ardhura nga qera vilash	6,241,393	15,097,257
Transport	167,296	31,824
Te ardhura nga ndertimi	-	151,366,632
Te ardhura nga ushqimi	146,396,146	145,188,043
Te ardhura nga ushqimi - mengjesi	2,947,397	3,401,884
Te ardhura nga ushqimi i perfituar	(465,046)	(400,148)
Te ardhura nga pijet - restoranti	35,206,341	37,278,520
Te ardhura nga pijet e perfituara	(2,297,966)	(2,692,679)
Te ardhura nga shitja e duhanit etj	458,396	81,668
Te ardhura nga shitja e inventarit Golem	4,040,686	-
<b>Total te ardhura nga shitja</b>	<b><u>606,664,937</u></b>	<b><u>750,952,450</u></b>

**20. Te ardhurat te tjera**

	<u>2014</u>	<u>2013</u>
Te ardhura nga qera dyqani dhe zyra	101,289,958	103,601,551
Te ardhura nga qendra e biznesit	25,791,564	27,486,947
Te ardhura nga telefoni dhe interneti	4,085,187	5,045,236
Te ardhura nga perdorimi i pishines	-	-
Te ardhura nga perdorimi i lavanderise	2,479,984	3,170,345
Te ardhura nga pishina - klubi i shendetit	9,182,825	10,122,766
Te ardhura te tjera	2,347,767	3,225,339
Te ardhura nga Pay TV	828,969	1,280,993
TE ardhura nga shitja e Aktiveve te Qendrushme	246,501,315	6,198,950
Rimarrje provizioni	2,757,333	-
<b>Total te ardhura te tjera</b>	<b><u>395,264,902</u></b>	<b><u>160,132,127</u></b>

**MAK ALBANIA sh.p.k**  
**Shenime mbi Pasqyrat Financiare te Shoqerise**  
**Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014 (vazhdon)**

Gjate vitit 2014 shoqeria ka shitur te gjitha aktivet afatgjata materiale dhe inventarin e divizionit Golem. Te ardhurat dhe rezultati nga shitja e tyre paraqiten si me poshte:

	<u>2014</u>
Te ardhura nga shitja e AAM-ve	246,501,315
Vlera kontabel neto e AAM-ve	(588,104,711)
<b>Rezultati nga shitja e AAM-ve</b>	<b><u>(341,603,396)</u></b>
Te ardhura nga shitja e inventarit	4,040,686
Kosto e mallit te shitur	(2,682,086)
<b>Rezultati nga shitja e inventarit</b>	<b><u>1,358,600</u></b>

Vlera kontabel neto e AAM-ve te shitura eshte perfshire ne zerin shpenzime te tjera.

**21. Materiale te para dhe te konsumueshme**

	<u>2014</u>	<u>2013</u>
Kosto e Mallrave te shitura	62,602,832	82,769,134
Furnitura, nentrajtime dhe sherbime	232,779,650	350,255,243
	<b><u>295,382,482</u></b>	<b><u>433,024,377</u></b>

**22. Shpenzime Personeli**

	<u>2014</u>	<u>2013</u>
Pagat e personelit	146,620,219	152,640,354
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	19,075,719	19,406,996
Provisione dhe shpenzime te tjera te panjohura personelin	900,577	1,614,724
	<b><u>166,596,515</u></b>	<b><u>173,662,074</u></b>

**MAK ALBANIA sh.p.k**  
**Shenime mbi Pasqyrat Financiare te Shoqerise**  
**Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014 (vazhdon)**

**23. Shpenzimet e Tjera**

	<u>2014</u>	<u>2013</u>
Shpenzime te tjera	103,640,705	79,183,402
Taksa	5,436,702	5,230,806
Provizione	13,235	37,806
Vlera kontabel neto e asetëve te shitura Golem	588,104,711	
	<u><u>697,195,353</u></u>	<u><u>84,452,014</u></u>

**24. Rezultati Financiar Neto**

Analiza e Rezultatit Financiar eshte si me poshte:

	<u>2014</u>	<u>2013</u>
Fitim nga kursi i kembimit	-	5,562,338
Humbje nga kursi i kembimit	(429,261)	-
Efekti neto nga kursi i kembimit	<u>(429,261)</u>	<u>5,562,338</u>
Te ardhura nga interesat	4,833,734	5,308,829
Shpenzime per interesat	(16,650,830)	(14,018,024)
Efekti neto nga interesat	<u>(11,817,096)</u>	<u>(8,709,195)</u>
Komisione per kartat	(8,741,961)	(7,406,182)
	<u><u>(20,988,318)</u></u>	<u><u>(10,553,039)</u></u>



**MAK ALBANIA sh.p.k**  
**Shenime mbi Pasqyrat Financiare te Shoqerise**  
**Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014 (vazhdon)**

**25. Rezultati Tatimor**

	<u>2014</u>	<u>2013</u>
Fitimi i periudhes	(554,315,676)	(198,498,253)
Shpenzime te panjohura	116,318,168	110,967,095
Shpenzime te konsumit personal	7,154,735	6,220,525
Provisione	937,586	1,677,277
Rimarrje Provizioni	(2,757,333)	
Gjoba Penalitete	640,785	2,588,824
Shpenzime pritje dhurata staf meal e discount	7,740	7,460,170
Shpenzime pa dokumenta te rregullta tatimore	7,227,505	249,840
Te tjera Shpenzime te Panjohura Sheraton	103,107,150	92,770,459
<b>Fitimi i tatueshem per periudhen</b>	<b>(437,997,508)</b>	<b>(87,531,158)</b>
Norma e tatim fitimit	15%	10%
Tatim fitimi	-	-
Tatim fitimi i parapaguar	-	-
Tatim fitimi per tu paguar	-	-

Te dhenat per humbjet e mbartura paraqiten ne tabelen e meposhtme:

	<u>2014</u>
Humbje tatimore e vitit 2012	(27,056,509)
Humbje tatimore e vitit 2013	(87,531,158)
Zvogelim I humbjes tatimore te vitit 2012 nga kontrolli tatimor 2014	10,095,097
Humbje e mbartur per vitet e ardhshme	<b>(104,492,570)</b>

**MAK ALBANIA sh.p.k**  
**Shenime mbi Pasqyrat Financiare te Shoqerise**  
**Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014 (vazhdon)**

**26. Evidentimi i diferencave ndermjet te Ardhurave ne PASH dhe atyre te deklaruarra ne FDP**

<b>Rakordimi i te ardhurave</b>	<b>2014</b>	<b>2013</b>
Te ardhura te deklaruarra ne PASH/ FDP tatim fitimi	1,001,929,839	911,084,577
Te ardhurat e deklaruarra ne FDP te TVSH	1,019,230,152	945,321,798
<b>Diferenca</b>	<b>(17,300,313)</b>	<b>(34,237,221)</b>
Rimarrja e te ardhurave te deklaruarra paradhenie ne vitin paraardhes	(82,556)	(945,157)
Faturime per paradhenie te marra per vitin pasardhes	582,556	416,667
Rimarrje provizionesh	(2,757,333)	
Vlera kontabel neto e AAM-ve te shitura te perfshira ne zerin te ardhura te tjera ne vitin 2013		19,495,936
Contra rent	3,844,658	
Diferenca kursi kembimi	808,350	322,204
Ushqimi per stafin (pritet fature dhe nuk deklarohet si e ardhur)	8,622,775	7,986,802
Mallra dhe sherbime te konsumuara nga stafi manaxherial	4,168,719	4,148,594
Skontot e aplikuarra	2,113,144	2,812,175
	<b>17,300,313</b>	<b>34,237,221</b>

**27. Kontigjenca e Angazhime**

Ndaj hotel Sheraton eshte ngritur nje padi nga nej prej ish punonjesve per pushim te padrejte nga puna. Gjykata e Rrethit Tirane pjesisht ka pranuar kerkesat e paditesit per 14 paga mujore, por hoteli e apeloj vendimin. Gjykata e apelit refuzoi kerkesat me te shumta te pales paditese, duke e ulir kompensimin deri ne pagen e 2 muajve. Nuk ka ndonje informacion ne rast se paditesi do te bejne rekurs per vendimin e Gjykates se Larte. Nuk ka nje vleresim se sa mund te jete shuma dhe kur mund te ndodhe.

Te ardhurat e ardhshme minimale nga qeraja te paraqitura nen zerin "Qera operative te pa anulleshme" jane si meposhte:

	<b>2014</b>	<b>2013</b>
Deri ne 1 vit	65,443,677	46,707,110
Deri ne 5 vjet	54,484,068	47,561,237
Me vone se 5 vjet	-	-
	<b>119,927,745</b>	<b>94,268,347</b>

Totali i qerases i njohur ne te ardhura gjate periudhes eshte 101,290 mije LEK (2013: 99,762 mije LEK).

*Shënimet Shpjeguese janë pjesë integrale e pasqyrave financiare*

## **28. Ngjarje pas dates se bilancit**

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së bilancit që kërkojnë rregullim ose paraqitje të mëtejshme në pasqyrat financiare.

## **29. Administrimi i rrezikur financiar**

- *Rreziku i normës së interesit*

Rreziku i normave të interesit është rreziku i luhatjeve të vlerave të instrumentave financiare si pasojë e ndryshimeve në tregun e normave të interesit dhe rreziku që maturitetet e interesave lidhur me aktivet ndryshojnë nga maturitetet e interesave të lidhura me detyrimet e përdorura për këto aktive. Hapësira e kohës për të cilën norma e interesit është e fiksuar për një instrument financiar tregon se në çfarë niveli Shoqeria është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit. Detyrimet e Shoqerise nuk mbajnë normat e interesit të tregut, sepse ajo ne afatgjate është e financuar nga ortaket. Shoqeria ka nje hua afathkurter ne formen e overdraftit.

- *Rreziku i kredisë*

Shoqeria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë për aktivet e saj financiare (llogaritë rrjedhëse), parapagimet dhe llogaritë e arkëtueshme. Shoqeria e kontrollon rrezikun e kredisë në mënyrë të vazhdueshme duke vëzhguar nga afër ekspozimin e saj ndaj parapagimeve dhe llogarive të arëtueshme nga palët e treta.

- *Rreziku i këmbimit valutor*

Shoqeria është e ekspozuar ndaj rrezikut të këmbimit valutor, duke qënë se transaksionet janë ndërmarrë si në monedhën vendase ashtu edhe në monedhë të huaj. Drejtimi monitoron dhe vendos limitet në nivelin e ekspozimit si nga çdo monedhë ashtu edhe në total.

- *Rreziku i likuiditetit*

Rreziku i likuiditetit është përcaktuar si rreziku kur maturitetet e aktiveve dhe detyrimeve nuk përputhen. Shoqeria e monitoron rrezikun e likuiditetit në mënyrë të vazhdueshme në mënyrë që të mbulojë detyrimet e veta kur ato maturohen. Detyrimet financiare përbëhen nga llogari të pagueshme gjatë rrjedhës normale të aktivitetit, detyrime të pagueshme ndaj kompanisë mëmë dhe shtetit.

## MAZARS SHPK

Address: Rruga Emin Duraku,  
Pall. Binjaket, No.5  
Tirana, 1000  
Tel. +355 4 222 2889  
Fax. +355 4 222 2889  
E-mail: [audit@mazars.al](mailto:audit@mazars.al)

[www.mazars.al](http://www.mazars.al)